

# UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA E KOSOVA AGENCIJA E AKREDITIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERSITET "HAXHI ZEKA" PEJË 
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>026</u>	Nr. / faq / Br. / str / No. / pg <u>23</u>	
Data / Datum / Date: <u>06.01.2023</u> Pejë / Peë		



## STRATEGJIA PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE-SHKENCORE DHE ARTISTIKE

Pejë, 2023

## PËRMBAJTJA

1. Hyrje .....	3
2. Qëllimi .....	4
3. Vizioni .....	5
4. Misioni.....	5
5. Objektivat .....	5
6. Monitorimi dhe vlerësimi.....	16
6.1. Matja e performancës .....	17
6.2. Rezultatet e pritura .....	17
PLANI ZHVILLIMOR DHE BUXHETI.....	21

## 1. Hyrje

Universiteti Publik "Haxhi Zeka" i cili u themelua si Universitet i pavarur në vitin 2011 është vazhdimësi e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Biznes (FSHAB) në Pejë.

FSHAB u themelua në vitin 1960 me vendimin e Këshillit Ekzekutiv të KSAK si "Shkolla e Lartë Ekonomike – Komerciale" në Pejë e cila fillimisht kishte vetëm seksionin e Afarizmit Komercial në Ndërmarrje dhe në fillet e saja kishte numër të kufizuar të mësimeve dhe studentëve. Veprimtaria dhe zhvillimi i "Shkollës së Lartë Ekonomike" u orientua në ndërtimin e planprogrameve të studimeve të rregullta që i përgjigjeshin kushteve ekonomiko shoqërore dhe nevojave të zhvillimit ekonomik të kohës. Në këtë mënyrë, u mundësoi mijëra studentëve nga të gjitha trojet shqiptare që të kryenin studimet dhe të avancojnë në karrierën e tyre.

"Shkolla e Lartë Ekonomike" në Pejë përjetoi disa periudha kohore mjaft interesante dhe të rëndësishme ekzistenciale. Si ato të viteve:

- 1960-1974, që ishte periudha e formimit dhe e krijimit të identitetit institucional;
- 1975- 1990, që ishte periudha e afirmimit të shkollës në Kosovë dhe në të gjitha vendet tjera përreth Kosovës;
- 1991-1999, që ishte periudha e mbijetesës, me anë të vazhimit të kontinuitetit nëpërmes organizimit paralel të mësimit nëpër shtëpi private;
- 2000 – 2006, që ishte periudha e riorganizimit të FSHAB-së ku:

"Shkolla e Lartë Ekonomike" u reformua sipas modelit të Deklaratës së Bolonjës dhe u riemërua "Shkolla e Biznesit" ku studimet zhvilloheshin në tri departamente: Administrim Biznesi, Informatikë e Aplikuar në Biznes dhe Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri. Në vitin 2002 organizohen studime në gjuhën boshnjake në departamentin Administrim Biznesi.

Nga viti 2004 "Shkolla e Biznesit" emërtohet "Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit". Që nga viti 2007 FSHAB studimet i zhvilloi në tri departamente: Departamenti Administrim Biznesi në të dy gjuhët (shqipe dhe boshnjake); Departamenti Kontabilitet dhe Financa të Biznesit; dhe Departamenti Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri. Në mars të vitit 2009 programet e FSHAB u akredituan nga Agjencioni për Akreditim në nivelin Bachelor dhe Master.

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë është themeluar në shtator të vitit 2011 me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës (vendim nr. 434/01B, datë 14.11.2011)

## Universiteti "Haxhi Zeka" sot

Universiteti "Haxhi Zeka" në përbërjen e vet ka pesë fakultete:

- Fakulteti i Biznesit;
- Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis;
- Fakulteti Juridik;
- Fakulteti i Agrobiznesit dhe
- Fakulteti i Arteve.

Universiteti "Haxhi Zeka" ka marrëdhënie bashkëpunimi me të gjitha institucionet shtetërore dhe ndërkombëtare që operojnë në Republikën e Kosovës. Ka gjithashtu marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar dhe është gjithashtu partner në projekte të ndryshme në kuadër të programeve siç janë: Erasmus +, TEMPUS, etj.

Universiteti "Haxhi Zeka" synon që nëpërmjet planit afatmesëm dhe afatgjatë të krijojë profil të ri në fushën e veprimtarisë akademike dhe në zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë aktualisht vijojnë studimet 11.254 studentë. Nga viti 2012 deri në vitin 2019 kanë përfunduar studimet mbi 4.455 studentë.

Menaxhmenti i lartë, i gjithë personeli akademik dhe administrativ i Universitetit janë të përkushtuar në ngritjen e cilësisë, që studentët tanë të jenë të aftë dhe konkurrues në tregun e punës.

## 2. Qëllimi

Strategjia për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike 2023-2026, ka për qëllim të pasqyrojë vizionin, misionin dhe objektivat e rëndësishme që duhet të plotësohen si përgjigje ndaj sfidave bashkëkohore të cilat kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme, si dhe realizimin e kërkesave gjithnjë e më të mëdha të akterëve të ndryshëm për njohuri të reja të bazuara në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike. Nëpërmjet kësaj strategjie ne do të bëjmë përsheptimin e përpjekjeve për të vendosur veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike në thelbin e gjithë veprimtarisë akademike të UHZ. Në bazë të kësaj strategjie, UHZ po ashtu synon të rris aktivitetin kërkimor shkencore dhe artistik, si një institucion që jo vetëm krijon dhe avancojnë njohuritë e reja, por edhe atë që jep kontribut të rëndësishëm në sfidat kryesore sociale, ekonomike dhe mjedisore në vend, rajon dhe më gjerë. Kjo nuk mund të bëhet pa një strategji të qartë, me njerëzit e duhur, burimet e duhura dhe të kuptuarit e mjedisit në të cilin veprojmë. Marrë parasysh se veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike brenda UHZ duhet të kontribuoj në zgjidhjen e sfidave të

ndryshme, objektivat dhe aktivitet e percaktuara në këtë strategji janë të ndërlidhura me Planin Strategjik 2023-2026.

### **3. Vizioni**

UHZ ka për synim që të jetë një institucion lider në vend dhe rajon në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike që përkonë me kërkesat e tregut në fushën e biznesit, agrobiznesit, mjedisit, turizmit, arteve, drejtësisë, aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe në fusha të tjera të ndërlidhura duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë vendore dhe me gjerë.

### **4. Misioni**

Universiteti "Haxhi Zeka" si institucion akademik transferon dije në funksion të realizimit të potencialit të studentëve drejt tregut dinamik të punës, i përkushtuar në hulumtime shkencore, veprimtari artistike dhe ndërkombëtarizim, për t'i shërbyer zhvillimit ekonomik të rajonit të Pejës dhe të vendit në përgjithësi. Nëpërmjet fushës së veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike, UHZ synon:

- Krijimin e njohurive të reja nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike të bazuara në standarde ndërkombëtare, si dhe zhvillimi i ideve inovative aplikative në funksion të plotësimit të nevojave të shoqërisë;
- Aplikimin e standardeve më të larta për arsimin universitar dhe pasuniversitar si përgjigje ndaj nevojave të tregut dhe sfidave të reja të shoqërisë bashkohore;
- Rekrutimin e studentëve dhe profesorëve më të mirë në fushat interdisiplinare në implementimin e strategjisë për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike në universitet;
- Vendosjen transparente të mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës për personelin akademik dhe hulumtuesit shkencor duke nënkuptuar këtu diversitetin dhe aspektin gjinor në universitet.

### **5. Objektivat**

Qëllimi i strategjisë për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike në UHZ, është që të konsolidojë dhe forcojë pozicionin e tij në të gjitha nivelet, duke ngritur veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike 50% për periudhën 2023-2026, por edhe të promovojë një mjedis të hapur intelektual në të cilin zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike është i bazuar në inovacion, dije dhe etikë dhe ka për synim zgjidhjen e problemeve e çështjeve komplekse me të cilat përballet shoqëria bashkëkohore.

Këto synime strategjike janë të përcjellura me një varg veprimesh me qëllim të sigurimit dhe avancimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike, ku për periudhën kohore 2023-2026, UHZ është përkushtuar në **Rritjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe krijimtarisë artistike** për të gjeneruar efekte si ato të nivelit të bashkëpunimit me universitete të tjera vendore dhe ndërkombëtare, inicim për aplikim në projekte të skemave të financimit të veprimtarive shkencore dhe artistike, si dhe, jo më pak i rëndësishëm kontributi afatgjatë në zhvillimin ekonomik dhe social në nivel lokal dhe kombëtar.

Për realizimin e kësaj objektive do të ndërmerren hapat si në vijim:

- Përmirësimi i infrastrukturës për kërkime shkencore dhe krijimtari artistike;
- Nxitja e veprimtarisë kërkimore shkencore dhe artistike;
- Funksionalizimi i "Institutit për Shkencë dhe Arte" (ISHA);
- Rritja e numrit të kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike.

### **Rezultati 1. Përmirësimi i infrastrukturës për kërkime shkencore dhe krijimtari artistike**

Lidhja midis kërkimit, arsimit dhe shoqërisë më të gjerë do të përforcohet dhe do të zhvillohet me iniciativa të ndryshme. Për më shumë, veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike në UHZ do të ketë një shtrirje të gjerë ndërdisiplinare dhe rezultatet e kërkimeve do të kontribuojnë në zhvillimin shoqëror, për të cilin shpesh kërkohet një qasje përtej kufijve kombëtar. Të kuptuarit e elementeve dhe forcave komplekse brenda natyrës dhe shoqërisë kërkon ekzaminim nga perspektiva e disiplinave të shumta. Sfidat kryesore të shoqërisë rrallherë mund të adresohen duke përdorur gjetjet vetëm me një disiplinë kërkimore, prandaj UHZ synon që nëpërmjet multidisiplinaritetit të krijoj sinergji dhe zhvillim të mundësive e ideve krijuese.

Duke e marrë parasysh se veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike është tejet e rëndësishëm për shoqërinë, për arritjen e këtij rezultati UHZ synon të realizoj aktivitetet si në vijim:

- 1.1. Krijimi dhe botimi i revistës shkencore;
- 1.2. Krijimi dhe botimi i gazetës studentore;
- 1.3. Qasja në sistemin informativ kërkimor (KRIS);
- 1.4. Qasja në databaza ndërkombëtare;
- 1.5. Qasja në sistemin anti-plagjiat;
- 1.6. Sigurimi i liçencave për programe softverike;
- 1.7. Kompletimi i laboratoreve me pajisje të nevojshme.

Rezultati 1. Përmirësimi i infrastrukturës për kërkime shkencore dhe krijimtari artistike		
Aktivitetet	Përshkrim i aktiviteteve	Treguesi i performancës
<b>Aktiviteti 1.1.1.</b> Krijimi dhe botimi i revistës shkencore	<p>UHZ do të krijojë një revistë shkencore multidisiplinare me karakter ndërkombëtar, e cila do të botohet nga UHZ.</p> <p>Për realizimin e kësaj reviste UHZ do të caktojë komisione të caktuara, të cilat do të merren me të gjitha procedurat e zhvillimit të saj duke përfshirë emrin, bordin, recensentet, etj.</p> <p>UHZ gjithashtu do ta promovojë këtë revistë edhe jashtë vendit nëpërmjet bashkëpunimeve që ka, në mënyrë që në këtë revistë të publikohen punime shkencore relevante dhe serioze nga hulumtues vendor e ndërkombëtarë.</p>	1. Revista e krijuar dhe e publikuar
<b>Aktiviteti 1.1.2.</b> Krijimi dhe botimi i gazetës studentore	<p>UHZ do të krijojë një revistë studentore e cila do të botohet nga UHZ.</p> <p>Për realizimin e kësaj reviste, UHZ në bashkëpunim me Parlamentin Studentor do të caktojë komisione të caktuara, të cilat do të merren me të gjitha procedurat e zhvillimit të saj duke përfshirë emrin, bordin, recensentët, etj.</p>	1. Revista e krijuar dhe e publikuar
<b>Aktiviteti 1.1.3.</b> Qasja në sistemin informative kërkimor (KRIS)	<p>UHZ-së do ti mundësohet qasja në databazën (platformën) KRIS në kuadër të projektit ResearchCult. Në këtë platformë do të plasohet revista e UHZ-së me të gjitha punime shkencore.</p>	1. Publikimi i revistës së UHZ-së në platformën KRIS.
<b>Aktiviteti 1.1.4.</b> Qasja në databaza ndërkombëtare	<p>UHZ do të vazhdojë përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve ekzistuese anti-plagjiat, si dhe zhvillimi dhe blerja e sistemeve të reja.</p>	1. Përdorimi i databazave ndërkombëtare
<b>Aktiviteti 1.1.5.</b> Qasja në sistemin anti-plagjiat	<p>UHZ në përputhje me nevojat dhe kërkesat e personelit akademik, do të vazhdojë anëtarësimin në databaza ndërkombëtare dhe do të vazhdojë të ofroj qasje pa pagesë në revista dhe databaza shkencore të publikimeve shkencore ndërkombëtare.</p> <p>Asociacioni i bibliotekave elektronike të Kosovës (J-Store,</p>	1. Përdorimi i sistemit anti-plagjiat

	EBSCO, Routledge, Springer, Elsevier etj).	
<b>Aktiviteti 1.1.6.</b> Sigurimi i liçencave për programe softverike	UHZ do të bleje liçencen për 2 programe softverike statistikore (SPSS, STATA, etj.).	1. Përdorimi i programeve softverike
<b>Aktiviteti 1.1.7.</b> Kompletimi i laboratoreve me pajisje të nevojshme	Të gjitha laboratorët në kuadër të UHZ-së (Agrobiznes dhe MTHM) do të kompletohen me të gjitha pajisjet e nevojshme laboratorike siç janë: mikroskopë, spektrofotometër, peshore digjitare, destilator, etj.	1. Blerja e pajisjeve dhe përdorimi i tyre.

## **Rezultati 2. Nxitja e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike**

Me qëllim të balancimit të aftësive ekzistuese me potencialin dhe mundësitë aktuale, do të përdoren në mënyrë optimale burimet që UHZ i posedon. Për më shumë, UHZ do të vazhdojë të zhvilloj gamën e saj duke e stimuluar veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike, kjo për arsye se kërkesat për burime financiare po bëhen gjithnjë e më të mëdha, ku edhe mundësitë për realizimin e tyre janë gjithnjë e më të komplikuar. Prandaj është thelbësore që sistemet financiare dhe buxhetore të jenë optimale dhe transparente për të gjitha kërkesat e tilla. Për të optimizuar suksesin tonë në këtë fushë, modeli ynë i buxhetit duhet të sinkronizohet për të mundësuar aktivitetin kërkimor në nivelin më të lartë. Kjo përfshin një kontroll të rregullt të modelit për të siguruar që ne jemi duke minimizuar pengesat, ose duke eliminuar sjelljet që janë paragjyqese për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike.

Andaj, për arritjen e këtij rezultati UHZ synon të realizoj aktivitetet si në vijim:

- 2.1. Rritja e buxhetit për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike;
- 2.2. Mbështetja financiare për publikimin e librave universitar;
- 2.3. Mbështetja financiare për punime shkencore të publikuara në WOS dhe SCOPUS;
- 2.4. Mbështetja financiare për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare;
- 2.5. Mbështetja financiare për projekte të vogla kërkimore;
- 2.6. Ndarja e çmimit "Hulumtuesi i vitit";
- 2.7. Ndarja e çmimit "Punimi më i mirë i vitit" & "Vepra artistike më e mirë e vitit";
- 2.8. Organizimi i aktiviteteve shkencore: trajnime, seminare, punëtori, simpoziume, tryeza të rumbullakëta, konferenca shkencore;
- 2.9. Organizimi i javës artistike studentore;
- 2.10. Organizimi i festivalit ndërkombëtar vjetor i Arteve;
- 2.11. Organizimi i koncerteve vendore dhe ndërkombëtare;
- 2.12. Organizimi i Koncertit Semestral.



<b>Rezultati 2. Nxitja e veprimtarisë kërkimore shkencore dhe artistike</b>		
<b>Aktiviteti</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<b>Treguesi i performancës</b>
<b>Aktiviteti 2.1</b> Rritja e buxhetit për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike	UHZ çdo vit do të bëjë rritje të buxhetit i për mbështetje financiare për publikimin e punimeve shkencore, ku 1 personel akademik do të ketë mundësi të financohet për 3 punime shkencore brenda 1 viti kalendarik.	1. Financimi i 3 punimeve shkencore për secilin personel akademik.
<b>Aktiviteti 2.2.</b> Mbështetja financiare për publikimin e librave universitar	UHZ do të ndaj buxhetin e veçantë për botimin e librave universitar nga personeli akademik.	1. Numri i librave universitar të financuar.
<b>Aktiviteti 2.3.</b> Mbështetja financiare për punimet shkencore të publikuara në WOS dhe SCOPUS	UHZ do të mbështet financiarisht personelin akademik për publikimin e punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare, serioze dhe të besueshme.  Mbështetja do të ofrohet për 3 punime shkencore, për secilin personel akademik, të publikuara në databaza WEB OF SCIENCE (duke përjashtaur revistat që janë të indeksuara në ESCI) ose SCOPUS.	1. Numri i përgjithshëm i punimeve shkencore të financuara.
<b>Aktiviteti 2.4.</b> Mbështetja financiare për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare	UHZ mbështet financiarisht personelin akademik për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare, serioze.	1. 1 konferencë për secilin personel akademik; 2. Numri i konferencave shkencore ndërkombëtare të financuara.
<b>Aktiviteti 2.5.</b> Mbështetja financiare për projekte të vogla kërkimore	UHZ ofron mbështetje financiare për projekte të vogla kërkimore për personelin akademik të rregullt. Brenda një viti kalendarik mbështeten 5 (pesë) projekte të vogla kërkimore (për secilën njësi akademike nga një projekt).	1. 1 projekt për secilën njësi akademike; 2. Numri i projekteve të vogla kërkimore të financuara.
<b>Aktiviteti 2.6.</b> Ndarja e Çmimit "Hulumtuesi i vitit"	Çdo vit UHZ do të shpall thirrje publike për përzgjedhjen e Hulumtuesit të vitit.	1. 1 çmim për secilën njësi akademike; 2. Numri i çmimeve të ndara.
<b>Aktiviteti 2.7.</b> Ndarja e Çmimit "Punimi më i mirë i vitit" & "Vepra artistike më e mirë e vitit"	Çdo vit UHZ do të shpall thirrje publike për përzgjedhjen e "Punimit më të mirë të vitit" & "Veprës artistike më të mirë të vitit".	1. 1 çmim për secilën njësi akademike; 2. Numri i çmimeve të ndara.
<b>Aktiviteti 2.8.</b> Organizimi i aktiviteteve shkencore: trajnime, seminare, punëtori, simpoziume, tryeza të rumbullakëta, konferenca shkencore	UHZ do të organizoj aktivitete të ndryshme shkencore si: - Konferenca shkencore ndërkombëtare; - Trajnime; - Seminare;	1. Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara; 2. Numri i pjesëmarrësve.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Punëtori,</li> <li>- Tryeza të rumbullakëta;</li> <li>- Koncerte;</li> <li>- Festivale;</li> <li>- Java artistike.</li> </ul>	
<b>Aktiviteti 2.9.</b> Organizimi i javës artistike studentore	<p>Për çdo vit UHZ, përkatësisht personeli dhe studentët e Fakultetit të Arteve të UHZ-së, do të organizojnë Javën Artistike Studentore, në kuadër të cilës do të ofrohen performanca dhe aktivitete të shumta e të ndryshme artistike e kulturore të përgatitura nga personeli dhe studentët e UHZ-së, por gjithashtu do të ftohen për pjesëmarrje dhe për prezantim të punës së tyre artistike e kulturore edhe personeli akademik dhe studentë të universiteteve të tjera vendore. Pjesëmarrja në javën artistike studentore do të jetë e hapur edhe për publikun e gjerë.</p> <p>Organizimi i këtij aktiviteti vjetor do të përkrahet financiarisht nga UHZ, nga buxheti i veçantë i paraparë për promovimin dhe përkrahjen e veprimtarisë dhe krijimtarisë artistike e kulturore, nga MASHT, MKRS, si dhe nga donatorë të ndryshëm.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Java artistike e organizuar;</li> <li>2. Numri i pjesëmarrësve.</li> </ol>
<b>Aktiviteti 2.10.</b> Organizimi i festivalit ndërkombëtar vjetor i Arteve	<p>Për çdo vit Fakulteti i Arteve i UHZ-së do të organizojë një festival ndërkombëtar. Organizimi i festivalit do të përkrahet financiarisht nga UHZ, nga buxheti i veçantë i paraparë për promovimin dhe përkrahjen e veprimtarisë dhe krijimtarisë artistike e kulturore, si dhe nga donatorë të ndryshëm.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Festivali ndërkombëtar i organizuar;</li> <li>2. Numri i pjesëmarrësve.</li> </ol>
<b>Aktiviteti 2.11.</b> Organizimi i koncerteve vendore dhe ndërkombëtare	<p>Për çdo vit UHZ, përkatësisht personeli dhe studentët e Fakultetit të Arteve do të realizojnë së paku 5 koncerte brenda vendit dhe 3 koncerte në shtete të ndryshme të botës.</p> <p>Në këto koncerte do të përformojnë personeli dhe studentët e Fakultetit</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Numri i koncerteve vendore të organizuar;</li> <li>2. Numri i koncerteve ndërkombëtare të organizuar;</li> <li>3. Numri i pjesëmarrësve.</li> </ol>

	të Arteve në përputhje me programin e paracaktuar. Organizimi i këtyre koncerteve do të përkrahet financiarisht nga UHZ, nga buxheti i veçantë i paraparë për promovimin dhe përkrahjen e veprimtarisë dhe krijimtarisë artistike e kulturore, si dhe nga donatorë të ndryshëm.	
<b>Aktiviteti 2.12.</b> Organizimi i Koncertit Semestral	Në kuadër të programit të studimeve të Fakultetit të Arteve të UHZ-së, studentët e këtij fakulteti në fund të çdo semestri do të organizojnë koncert semestral, të cilët përveç për studentët e UHZ-së do të jetë e hapur edhe për publikun e gjerë.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Koncerti semestral i organizuar;</li> <li>2. Numri i pjesëmarrësve.</li> </ol>

### **Rezultati 3. Funksionalizimi i "Institutit për Shkencë dhe Arte" (ISHA)**

Me funksionalizimin e institutit synohet të ofrohen mundësitë për burime shtesë ose të larmishme të financimit, si dhe të krijoj bashkëpunime me institutet kombëtare e ndërkombëtare dhe biznese lokale në realizimin e kërkimeve aplikative dhe projekteve kërkimore. Ky instrument mbështetet në informacione të sakta dhe të besueshme kërkimore për të realizuar planifikimin strategjik, për të menaxhuar procesin e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike, si dhe për të përmirësuar raportimin tek organet e jashtme siç janë financuesit dhe organet qeveritare.

Duke e marrë parasysh se qeverisja e mirë dhe një sistem i menaxhimit efektiv është faktor kyç në zhvillimin e kërkimit intensiv të një universiteti, për arritjen e këtij rezultati UHZ synon të realizoj aktivitetet si në vijim:

- 1.1. Rritja e fondeve vetanake;
- 1.2. Rritja e bashkëpunimeve me institute kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 1.3. Rritja e bashkëpunimeve me biznese lokale në realizimin e kërkimeve aplikative;
- 1.4. Rritja e bashkëpunimeve me biznese lokale në realizimin e projekteve kërkimore.

<b>Rezultati 3. Funkcionalizimi i "Institutit për Shkencë dhe Arte"</b>		
<b>Aktiviteti</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<b>Treguesi i performancës</b>
<b>Aktiviteti 3.1.</b> Rritja e fondeve vetanake	UHZ nëpërmjet Institutit për Shkencë dhe Arte do të gjenerojë të ardhura vetanake duke realizuar kërkime konkrete për nevojat e industrisë. Ky aktivitet do të ndikojë në rritjen e buxhetit për kërkime shkencore.	1. Fondet e fituara/realizuara.
<b>Aktiviteti 3.2.</b> Rritja e bashkëpunimeve me institute kombëtare dhe ndërkombëtare	UHZ nëpërmjet Institutit për Shkencë dhe Arte do të risë bashkëpunimin me fushën e kërkimeve me institute brenda vendi sic janë Instituti Bujqësore në Pejë, GENKOS etj., si dhe me institute jashtë vendit.	1. Numri i bashkëpunimeve të realizuara; 2. Numri i pjesëmarrësve:
<b>Aktiviteti 3.3.</b> Rritja e bashkëpunimeve me biznese lokale në realizimin e kërkimeve aplikative	UHZ nëpërmjet Institutit për Shkencë dhe Arte do të jetë në dispozicion të bizneseve për realizimin e studimeve kërkimore sipas nevojave të tyre.	1. Numri i bashkëpunimeve të realizuara; 2. Numri i pjesëmarrësve.
<b>Aktiviteti 3.4.</b> Rritja e bashkëpunimeve me biznese lokale në realizimin e projekteve kërkimore	UHZ nëpërmjet Institutit për Shkencë dhe Arte do të përfshijë bizneset lokale në projektet e veta kërkimore.	1. Numri i bashkëpunimeve të realizuara; 2. Numri i pjesëmarrësve.

#### **Rezultati 4. Rritja e numrit të kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike**

Një dimension gjithnjë e më i rëndësishëm i strategjisë sonë do të jetë realizimi i aktiviteteve shkencore nga personeli akademik në bashkëpunim me studiues të tjerë, studentë dhe me një komunitet më të gjerë. Kjo do të ndërtojë rrjete të forta kërkimore dhe infrastrukturë me aftësi për të adresuar çështjet e rëndësishme dhe për të gjeneruar njohuri të reja.

Bashkëpunimet kërkimore të kësaj natyre paraqesin mundësi strategjike për të përmirësuar shkallën, cilësinë dhe ndikimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve realizohen përfitime të shumta ku hulumtuesit janë të ekspozuar ndaj perspektivave të ndryshme. Për më shumë ato sjellin aftësi të nevojshme plotësuese nga burimet dhe infrastruktura të ndryshme si dhe mund të ofrojnë qasje në ekspertizë specifike të industrisë. Partneritetet strategjike me studiuesit ndërkombëtar mund të sjellin njohje ndërkombëtare për universitetin dhe përfitime për programet mësimore dhe kërkimore. Andaj, për arritjen e këtij rezultati UHZ synon të realizoj aktivitetet si në vijim:

- 4.1. Numri i punimeve shkencore të publikuara nga personeli akademik (89%);  
Numri i punimeve shkencore të personelit akademik të financuara nga UHZ (67%);
- 4.2. Numri i pjesëmarrjes së personelit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare (89%);
- 4.3. Numri i pjesëmarrjes së personelit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare të financuara nga UHZ (67%);
- 4.4. Numri i projekteve të vogla kërkimore të financuara nga UHZ (5 projekte);
- 4.5. Numri i librave universitar të publikuar nga personeli akademik (5 libra universitar);
- 4.6. Numri i librave universitar të publikuar nga personeli akademik, të financuara nga UHZ (5 libra universitar);
- 4.7. Numri i pjesëmarrjes së personelit akademik në aktivitete shkencore: trajnimeve, seminareve, punëtorive, simpoziume, tryeza të rumbullakëta (100%);
- 4.8. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me universitete kombëtare (20%);
- 4.9. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me universitetet ndërkombëtare (20%);
- 4.10. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me kolegët e brendshëm (60%);
- 4.11. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me studentët (50%);
- 4.12. Realizimi i kërkimeve aplikative (20%);
- 4.13. Përfshirja e punimeve shkencore në syllabusë (80%);
- 4.14. Pjesëmarrja e personelit akademik në koncerte ndërkombëtare (14%);
- 4.15. Pjesëmarrja e personelit akademik dhe e studentëve në festivale ndërkombëtare (14%).

Rezultati 4. Rritja e numrit të kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike		
Aktiviteti	Përshkrim i aktivitetit	Treguesi i performancës
<b>Aktiviteti 4.1.</b> Numri i punimeve shkencore të publikuara nga personeli akademik	Zyra për kërkime shkencore do të krijoj bazën e të dhënave me qëllim të identifikimit të numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të personelit akademik. Po ashtu, ZKSH publikon bazën e të dhënave, në faqen zyrtare të UHZ-së, 2x brenda vitit kalendarik.	1. 89% e personelit akademik; 2. Krijimi i databazës; 3. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së.
<b>Aktiviteti 4.2.</b> Numri i punimeve shkencore të personelit akademik të financuara nga UHZ	Zyra për kërkime shkencore do të krijoj bazën e të dhënave të punimeve shkencore të personelit akademik, të financuara nga UHZ. Po ashtu, ZKSH publikon bazën e të dhënave, në faqen zyrtare të UHZ-së, 4x brenda vitit kalendarik.	1. 67% e personelit akademik; 2. Krijimi i databazës; 3. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së.
<b>Aktiviteti 4.3.</b> Numri i pjesëmarrjes së personelit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare	Zyra për kërkime shkencore do të krijoj bazën e të dhënave me qëllim të identifikimit të numrit të përgjithshëm të pjesëmarrjes së	1. 89% e personelit akademik; 2. Krijimi i databazës; 3. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së.

	<p>personelit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare.</p> <p>Po ashtu, ZKSH publikon bazën e të dhënave, në faqen zyrtare të UHZ-së, 2x brenda vitit kalendarik</p>	
<p><b>Aktiviteti 4.4.</b> Numri i pjesëmarrjes së personelit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare të financuara nga UHZ</p>	<p>Zyra për kërkime shkencore do të krijoj bazën e të dhënave të pjesëmarrjes së personelit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare, të financuara nga UHZ.</p> <p>Po ashtu, ZKSH publikon bazën e të dhënave, në faqen zyrtare të UHZ-së, 4x brenda vitit kalendarik.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 67% e personelit akademik;</li> <li>2. Krijimi i databazës;</li> <li>3. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së.</li> </ol>
<p><b>Aktiviteti 4.5.</b> Numri i projekteve të vogla kërkimore të financuara nga UHZ</p>	<p>Zyra për kërkime shkencore do të krijoj bazën e të dhënave të projekteve të vogla kërkimore të personelit akademik, të financuar nga UHZ.</p> <p>Po ashtu, ZKSH publikon bazën e të dhënave, në faqen zyrtare të UHZ-së, 1x brenda vitit kalendarik.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 5 projekte;</li> <li>2. Krijimi i databazës;</li> <li>3. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së.</li> </ol>
<p><b>Aktiviteti 4.6.</b> Numri i librave universitar të publikuar nga personeli akademik</p>	<p>Zyra për kërkime shkencore do të krijoj bazën e të dhënave të numrit të përgjithshëm të librave universitar të publikuar nga personeli akademik.</p> <p>Po ashtu, ZKSH publikon bazën e të dhënave, në faqen zyrtare të UHZ-së, 2x brenda vitit kalendarik.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 5 libra universitar;</li> <li>2. Krijimi i databazës;</li> <li>3. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së</li> </ol>
<p><b>Aktiviteti 4.7.</b> Numri i librave universitar nga personeli akademik, të financuara nga UHZ</p>	<p>Zyra për kërkime shkencore do të krijoj bazën e të dhënave të librave universitar të personelit akademik, të financuar nga UHZ.</p> <p>Po ashtu, ZKSH publikon bazën e të dhënave, në faqen zyrtare të UHZ-së, 1x brenda vitit kalendarik.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 5 libra universitar;</li> <li>2. Krijimi i databazës;</li> <li>3. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së</li> </ol>
<p><b>Aktiviteti 4.8.</b> Numri i pjesëmarrjes së personelit akademik në aktivitete shkencore: trajnimeve, seminareve, punëtorive, simpoziume, tryeza të rumbullakëta</p>	<p>Zyra për kërkime shkencore do të krijoj bazën e të dhënave të aktiviteteve shkencore të personelit akademik.</p> <p>Po ashtu, ZKSH publikon bazën e të dhënave, në faqen zyrtare të UHZ-së, 2x brenda vitit kalendarik.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 100% e personelit akademik;</li> <li>2. Krijimi i databazës;</li> <li>3. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së</li> </ol>
<p><b>Aktiviteti 4.9.</b> Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me universitete kombëtare</p>	<p>UHZ do të përkrahë realizimin e kërkimeve shkencore, të cilat do të realizohen në bashkëpunim mes disa profesorëve të UHZ-së dhe disa kolegëve të tyre nga universitetet vendore në Kosovë nëpërmjet projekteve të vogla kërkimore.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 20% e personelit akademik;</li> <li>2. Numri i bashkëpunimeve të realizuara;</li> <li>3. Krijimi i databazës;</li> <li>4. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së</li> </ol>

	<p>Po ashtu, Zyra për Kërkime Shkencore krijon bazën e të dhënave për bashkëpunimet e personelit akademik me bashkëpunëtorët nga univeversitetet tjera kombëtare, dhe të njëjtën e publikon në faqen zyrtare 2x brenda vitit kalendarik.</p>	
<p><b>Aktiviteti 4.10.</b> Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me universitetet ndërkombëtare</p>	<p>UHZ përkrahë realizimin e kërkimeve shkencore, të cilat kanë potencial të realizohen në bashkëpunim mes disa profesorëve të UHZ-së dhe disa kolegëve të tyre nga universitete ndërkombëtare.</p> <p>Po ashtu, Zyra për Kërkime Shkencore krijon bazën e të dhënave për bashkëpunimet e tilla, dhe të njëjtën e publikon në faqen zyrtare 2x brenda vitit kalendarik.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 20% e personelit akademik;</li> <li>2. Numri i bashkëpunimeve të realizuara;</li> <li>3. Krijimi i databazës;</li> <li>4. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së</li> </ol>
<p><b>Aktiviteti 4.11.</b> Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me kolegët e brendshëm</p>	<p>UHZ do të përkrahë realizimin e kërkimeve shkencore, të realizuara nga një grup profesorësh të UHZ-së.</p> <p>Po ashtu, Zyra për Kërkime Shkencore krijon bazën e të dhënave për bashkëpunimet e tilla, dhe të njëjtën e publikon në faqen zyrtare 2x brenda vitit kalendarik.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 60% e personelit akademik;</li> <li>2. Numri i bashkëpunimeve të realizuara;</li> <li>3. Krijimi i databazës;</li> <li>4. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së.</li> </ol>
<p><b>Aktiviteti 4.12.</b> Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me studentët</p>	<p>Në përputhje me karakteristikat dhe mundësitë që ekzistojnë në kuadër të kërkimeve shkencore aplikative që realizohen nga personeli akademik i UHZ-së, në këto kërkime do të përfshihen edhe studentët në përputhje me kompetencën e tyre profesionale, në mënyrë që studentët të njihen sa më shumë me kërkimet shkencore. Në kuadër të procesit mësimor, studentët do të angazhohen edhe në projekte të vogla kërkimore.</p> <p>Po ashtu, Zyra për Kërkime Shkencore krijon bazën e të dhënave për bashkëpunimet e tilla, dhe të njëjtën e publikon në faqen zyrtare 2x brenda vitit kalendarik.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 50% e personelit akademik;</li> <li>2. Numri i bashkëpunimeve të realizuara;</li> <li>3. Krijimi i databazës;</li> <li>4. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së.</li> </ol>
<p><b>Aktiviteti 4.13.</b> Realizimi i kërkimeve aplikative</p>	<p>Zyra për Kërkime Shkencore, në bashkëpunim me Institutin për Shkencë dhe Arte si dhe me personelin akademik, do të identifikojë biznese e kompani të</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 20% pjesëmarrja e personelit akademik;</li> <li>2. Numri i kërkimeve aplikative të realizuara;</li> <li>3. Krijimi i databazës;</li> </ol>

	ndryshme, të cilat janë të interesuara për kërkime aplikative dhe të cilat janë të gatshme të përkrahin financiarisht këto kërkime.	4. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së.
<b>Aktiviteti 4.14.</b> Përfshirja e punimeve shkencore në syllabusë	Personeli akademik do të përfshijë punimet e tyre shkencore në përmbajtje mësimore/syllabusë.  Po ashtu, Zyra për Kërkime Shkencore krijon bazën e të dhënave për këtë aktivitet, dhe të njëjtën e publikon në faqen zyrtare 2x brenda vitit kalendarik.	1. 80% pjesëmarrja e personelit akademik; 2. Numri i syllabusëve të përditësuar; 3. Krijimi i databazës; 4. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së.
<b>Aktiviteti 4.15.</b> Pjesëmarrja e personelit akademik në koncerte ndërkombëtare	Për çdo vit, UHZ, do të përkrahë personelin akademik të fakultetit të arteve për të marrë pjesë në koncerte ndërkombëtare.	1. 14% pjesëmarrja e personelit akademik; 2. Numri i pjesëmarrësve; 3. Krijimi i databazës;
<b>Aktiviteti 4.16.</b> Pjesëmarrja e personelit akademik dhe e studentëve në festivale ndërkombëtare	Për çdo vit UHZ do të përkrahë personelin akademik dhe studentë të Fakultetit të Arteve të UHZ-së për të marrë pjesë në festivale të rëndësishme ndërkombëtare. Pjesëmarrja në këto festivale do të përkrahët financiarisht nga UHZ, nga buxheti i veçantë i paraparë për promovimin dhe përkrahjen e veprimtarisë dhe krijimtarisë artistike e kulturore, si dhe nga donatorë të ndryshëm.	1. 14% pjesëmarrja e personelit akademik; 2. 50% pjesëmarrja e studentëve 3. Numri i pjesëmarrësve; 4. Krijimi i databazës; 5. Publikimi i databazës në faqen zyrtare të UHZ-së.

## 6. Monitorimi dhe vlerësimi

Në strategjinë për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike të UHZ është thelbësore përcjellja e progresit dhe monitorimi i secilit program, projekt dhe aktivitet i planifikuar prandaj korigjimet eventuale si rishikim për të kthyer sistemin në drejtimin e duhur, duhet të jenë në qendër të hartimit të programit të bazuar në prova, dhe në përgjegjësi për rastet kur sistemi nuk është duke funksionuar sipas parashikimeve.

Të kuptuarit e procesit të monitorimit dhe vlerësimit është thelbësore për të përmirësuar strategjinë tonë. Një plan i detajuar i monitorimit dhe vlerësimit është i nevojshëm për të shërbyer si një strukturë funksionale e cila ka për qëllim për të monitoruar dhe rishikuar fushat, projektet, iniciativat dhe planet kryesore të identifikuara në Strategjinë për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike.

Një plan i tillë do të zhvillohet në konsultim me palët kryesore të interesit dhe është i nevojshëm ndër të tjera për evidentimin e rezultateve të arritura, mundësimin e



monitorimit të progresit ndaj synimeve të strategjisë dhe kërkesat për financimin e aktiviteteve të rishikuara.

Plani i monitorimit dhe vlerësimit, do të jetë fleksibël dhe i arsyeshëm, dhe vazhdimisht do të shërbejë për të ripërcaktuar, rishikuar dhe përmirësuar përparësitë dhe objektivat e Strategjisë për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike.

Ne kemi identifikuar një seri indikatorësh për të vlerësuar përparimin dhe arritjet e përgjithshme të performancës. Në vazhdim do të zhvillojmë një plan të qartë zbatimi të vlerësimit dhe një kornizë të detajuar monitorimi për të matur progresin e strategjisë sonë. Në veçanti, ne do të përcaktojmë masat e performancës me qëllimet strategjike të përshkuara në këtë strategji.

### **6.1. Matja e performancës**

- a) Rritja e numrit të personelit akademik në kërkime shkencore në të gjitha fushat e synuara në shkallën 50% për periudhën 2023-2026;
- b) Rritja e punimeve shkencore të publikuara në revistat ndërkombëtare të indeksuara në WOS dhe SCOPUS në shkallën 50% për periudhën 2023-2026;
- c) Krijimi dhe rritja e bashkëpunimeve të Institutit për Shkencë dhe Arte me institute kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me biznese lokale;
- d) Rritja e numrit të bashkëpunimeve të personelit akademik me kolegë të brendshëm, të jashtëm dhe studentë;
- e) Rritja e vëllimit dhe vlerës së kërkimeve në bashkëpunim me institucione ndërkombëtare në shkallën 50% për periudhën 2023-2026;
- f) Rangimi i UHZ në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar në platformën WEBOMETRICS në shkallën 50% për periudhën 2023-2026.

### **6.2. Rezultatet e pritura**

Implementimi i strategjisë për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike do të ndikoj që UHZ:

- a) Të njihet si një Universitet i dalluar jo vetëm në studime por edhe në kërkime shkencore dhe artistike;
- b) Të gjitha burimet e disponueshme të harmonizoj me strategjinë për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike;
- c) Të njihet puna kërkimore dhe artistike nëpërmjet Institutit për Shkencë dhe Arte;
- d) Të rrisë bashkëpunimet me organizatat e jashtme që do të gjenerojnë nisma të përbashkëta dhe forcimin e kërkimeve dhe zgjerimin e aftësive kërkimore;

- e) Të rrisë buxhetin, sistemet mbështetëse dhe infrastruktura kërkimore që do të ndihmojnë në nxitjen e kërkimeve dhe të përsosmërisë së kërkimit.
- f) Të rrisë bashkëpunimet me studentët në fushën e kërkimeve shkencore dhe artistike dhe ti pajis ata me njohuri inovative për të përgatitur për tregun dinamik të punës;
- g) Të siguroj që njohurit e arritura të pranohen edhe ndërkombëtarisht.



**Kryesuesi i Senatit**

**Prof.dr. Armand Krasniqi**

**PLANI ZHVILLIMOR DHE BUXHETI**

Nr.	Veprimi/ Aktivitet	Përiudha e zbatimit	Buxheti				Burimi i Financimit	Stafi/Pergjegjesit	Produkti(Outputi)
			2023	2024	2025	2026			
<b>4.1. Përmirësimi i infrastrukturës së kërkime shkencore dhe krijimtari artistike</b>									
1.	Aktiviteti 4.1.1. Krijimi dhe botimi i revistës shkencore	Krijimi 2023 Botimi çdo vit 2023-2026 Gershor & Dhjetor	5000.00	5000.00	5000.00	5000.00	20000.00	Rektorati Zyra për Kërkime Shkencore KD	Vëllimet e publikuara
2.	Aktiviteti 4.1.2. Krijimi dhe botimi i gazetës studentore	Krijimi 2023 Botimi çdo vit 2023-2026 Maj - qershor	1000.00	1000.00	1000.00	1000.00	4000.00	Rektori Parlamenti studentor	Vëllimet e publikuara
3.	Aktiviteti 4.1.3. Qasja në sistemin informativ kërkimor (KRIS)	Qasja 2023 Çdo vit 2023-2025 Gershor & Dhjetor	0.00	0.00	0.00	0.00	N/A	ResearchCult Zyra për Kërkime Shkencore	Sigurimi i qasjes
4.	Aktiviteti 4.1.4. Qasja në databaza ndërkombëtare	Çdo vit 2023-2026	1000.00	1000.00	1000.00	1000.00	4000.00	Rektorati Njësitë akademike Zyra e IT-së	Përdorimi i databazave
5.	Aktiviteti 4.1.5. Qasja në sistemin anti-plagjiat	Çdo vit 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	N/A	Zyra për Kërkime Shkencore Njësitë akademike Zyra e IT-së	Përdorimi i sistemit anti-plagjiat
6.	Aktiviteti 4.1.6. Sigurimi i licencave për programe softverike	Çdo vit 2023-2026	1000.00	1000.00	1000.00	1000.00	4000.00	Rektorati Zyra për Kërkime Shkencore Zyra e IT-së	Përdorimi i programeve softverike
7.	Aktiviteti 4.1.7. Kompletimi i laboratoreve me pajisje të nevojshme	Çdo vit 2023-2026	10000.00	10000.00	10000.00	10000.00	KD Donatorët	Rektorati Zyra e prokurimit Njësitë akademike	Blerja e pajisjeve
<b>4.2. Nxitja e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike</b>									

8.	Aktiviteti 4.2.1. % e rritjes së buxhefit për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike	Çdo vit 2023-2026	120000	120000	120000	120000	120000	120000	480000	UHZ	Rektorati KD	Financimi i 3 punimeve shkencore për 1 personel akademik
9.	Aktiviteti 4.2.2. Mbështetja financiare për publikimin e librave universitar	Çdo vit në nëntor - dhjetor 2023 – 2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	UHZ (buxhefi i paraparë në pikën 4.2.1)	Prorektori për mësimdhënie, çështje studentore dhe kërkime shkencore Këshilli i botimeve Njësitë akademike	Numri i librave universitar të financuara nga UHZ
10.	Aktiviteti 4.2.3. Mbështetja financiare për punimet shkencore të publikuara në WOS dhe SCOPUS	Çdo 3 muaj 2023 – 2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	UHZ (buxhefi i paraparë në pikën 4.2.1)	Zyra për Kërkime Shkencore Grupi për Kërkime Shkencore	Numri i punimeve shkencore të mbështetura
11.	Aktiviteti 4.2.4. Mbështetja financiare për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare	Çdo 3 muaj 2023 – 2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	UHZ (buxhefi i paraparë në pikën 4.2.1)	Zyra për Kërkime Shkencore Grupi për Kërkime Shkencore	Numri i konferencave shkencore ndërkombëtare të mbështetura
12.	Aktiviteti 4.2.5. Mbështetja financiare për projekte të vogla kërkimore	Çdo vit në shtator 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	UHZ (buxhefi i paraparë në pikën 4.2.1)	Zyra për Kërkime Shkencore Grupi për Kërkime Shkencore	Numri i projekteve të vogla kërkimore të mbështetura
13.	Aktiviteti 4.2.6. Ndarrja e Çmimit "Hulumtuesi i vitit"	Çdo vit në nëntor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	UHZ (buxhefi i paraparë në pikën 4.2.1)	Zyra për Kërkime Shkencore Grupi për Kërkime Shkencore	Numri i çmimeve të ndara
14.	Aktiviteti 4.2.7. Ndarrja e Çmimit "Punimi më i mirë i vitit" & "vepra artistike më e mirë e vitit"	Çdo vit në nëntor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	UHZ (buxhefi i paraparë në pikën 4.2.1)	Zyra për Kërkime Shkencore Grupi për Kërkime Shkencore	Numri i çmimeve të ndara
15.	Aktiviteti 4.2.8. Organizimi i aktiviteteve shkencore: trajnime, seminare, punëtori, simpoziume, tryeza të rumbullakëta, konferenca shkencore	Çdo vit 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	Projekte	Rektorati Zyra për Kërkime Shkencore Njësitë akademike	Numri i aktiviteteve të organizuara
16.	Aktiviteti 4.2.9. Organizimi i javës artistike studentore	Çdo vit në maj-qershor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	MASHT MKRS DKRS/Pejë Donatorët	Rektorati Fakulteti i Arteve	Java artistike studentore e organizuar

17.	Aktiviteti 4.2.10. Organizimi i festivalit ndërkombëtar vjetor i Arteve	Çdo vit 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	MASHT MKRS DKRS/Pejë Donatorët	Rektorati Fakulteti i Arteve	Festivali ndërkombëtar i organizuar
18.	Aktiviteti 4.2.11. Organizimi i koncerteve vendore dhe ndërkombëtare	Çdo vit në prill & nëntor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	Rektorati Fakulteti i Arteve	MASHT MKRS DKRS/Pejë Donatorët	Numri i koncerteve vendore dhe ndërkombëtare të organizuar
19.	Aktiviteti 4.2.12. Organizimi i Koncertit Semestral	Çdo vit në janar 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	DKRS/Pejë	Rektorati Fakulteti i Arteve	Koncerti semestral i mbajtur
<b>4.3. Funksionalizimi i "Instituit për Shkencë dhe Arte"</b>												
20.	Aktiviteti 4.3.1. Rrija e fondeve vetanake	Çdo vit 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	UHZ	Rektorati Instituti për Shkencë dhe Arte	Fondet vetanake të realizuara
21.	Aktiviteti 4.3.2. Rrija e bashkëpunimeve me institute kombëtare dhe ndërkombëtare	Çdo vit 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	UHZ	Rektorati Instituti për Shkencë dhe Arte	Numri i bashkëpunimeve të realizuara me institutet kombëtare dhe ndërkombëtare
22.	Aktiviteti 4.3.3. Rrija e bashkëpunimeve me biznese lokale në realizimin e kërkimeve aplikative	Çdo vit 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	Fonde vetanake	Rektorati Instituti për Shkencë dhe Arte Bizneset lokale	Numri i bashkëpunimeve të realizuara me biznese lokale
23.	Aktiviteti 4.3.4. Rrija e bashkëpunimeve me biznese lokale në realizimin e projekteve kërkimore	Çdo vit 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	Fonde vetanake	Rektorati Instituti për Shkencë dhe Arte Bizneset lokale	Numri i bashkëpunimeve të realizuara me biznese lokale
<b>4.4. Rrija e numrit të kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike</b>												
24.	Aktiviteti 4.4.1. Numri i punimeve shkencore të publikuara nga personeli akademik	Çdo vit në qershor – dhjetor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	N/A	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së

25.	Aktiviteti 4.4.2. Numri i punimeve shkencore të personelit akademik të financuara nga UHZ	Çdo vit në mars, qershor, shtator, nëntor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	N/A	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
26.	Aktiviteti 4.4.3. Numri i pjesëmarrjes së personelit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare	Çdo vit në qershor & dhjetor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	N/A	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
27.	Aktiviteti 4.4.4. Numri i pjesëmarrjes së personelit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare të financuara nga UHZ	Çdo vit në mars, qershor, shtator, nëntor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	N/A	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
28.	Aktiviteti 4.4.5. Numri i projekteve të vogla kërkimore të financuara nga UHZ	Çdo vit në shtator 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	N/A	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
29.	Aktiviteti 4.4.6. Numri i librave universitar të publikuar nga personeli akademik	Çdo vit në qershor – dhjetor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	N/A	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
30.	Aktiviteti 4.4.7. Numri i librave universitar nga personeli akademik, të financuara nga UHZ	Çdo vit në dhjetor 2023 - 2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	KD	Prorektori për mësimdhënie, çështje studentore dhe kërkime shkencore Këshilli i botimeve Njësitë akademike	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
31.	Aktiviteti 4.4.8. Numri i pjesëmarrjes së personelit akademik në aktivitete shkencore: trajnimeve, seminareve, punëtorive, simpoziume, tryeza të rrumbullakëta	Çdo vit në qershor & dhjetor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	N/A	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
32.	Aktiviteti 4.4.9. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me universitete kombëtare	Çdo vit në qershor & dhjetor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	MASHT (buxheti për kërkime) Donatorët	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së

33.	Aktiviteti 4.4.10. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me universitetet ndërkombëtare	Çdo vit në qershor & dhjetor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	KD MASHT Donatorët	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
34.	Aktiviteti 4.4.11. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me kolegjet e brendshëm	Çdo vit në qershor & dhjetor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	KD	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
35.	Aktiviteti 4.4.12. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me studentët	Çdo vit në qershor & dhjetor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	KD	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik Studentët	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
36.	Aktiviteti 4.4.13. Realizimi i kërkimeve aplikative	Çdo vit në qershor & dhjetor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	UHZ	Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
37.	Aktiviteti 4.4.14. Përfshirja e punimeve shkencore në sylabusë	Çdo vit në shkurt & tetor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	UHZ	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
38.	Aktiviteti 4.4.15. Pjesëmarrja e personelit akademik në koncerte ndërkombëtare	Çdo vit në qershor & dhjetor 2023-2026	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	UHZ	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së
39.	Aktiviteti 4.4.16. Pjesëmarrja e personelit akademik dhe e studentëve në festivale ndërkombëtare	Çdo vit në qershor & dhjetor 2023-2026	3000.00	3000.00	3000.00	3000.00	3000.00	3000.00	3000.00	12000.00	MASHT MKRS DKRS/Pejë Donatorët	Zyra për Kërkime Shkencore Personeli akademik I FA	Databaza e publikuar në faqen zyrtare të UHZ-së